

31818

**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**

**Nr. 31818 Vendimit**

**V E N D I M**

**PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK**

*Anje me Coco* - Ne Tirane, sot me date 23.06.2004, une gjyqtaria e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane z. Shpetim Sukthi, si ortak I vetem dhe administrator i shoqerise, per rregjistrimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "Gips-Karton" sh.p.k., si person juridik,

**K O N S T A T O V A:**

Kerkuesi kerkon rregjistrimin si person juridik privat te shoqerise me perjegjesi te kufizuar "Gips-Karton" sh.p.k., me ortak te vetem z. Shpetim Sukthi, lindur me 04.09.1973, ne Tirane, banues ne rrugen "Pjeter Bogdani", Pallatet e Avacionit, Nr.5, Tirane.

Administrator i shoqerise do te jete z. Shpetim Sukthi.

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet.

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke.

Adresa e shoqerise: rruga "Pjeter Bogdani", Nr.5, Tirane,

Me objekt veprimtarie si me poshte: "Importe-eksport, me shumice e pakice te lendeve te para, materialeve te ndertimit, pajisjeve, makineri, etj; Punime dekorative me baze gips; Veprimitari ne fushen e sherbimeve, manifakture, perpunime industriale, transport, etj; Konsulence marketingu e sherbime te ngashme, misione tregtare, kerkim tregu, byro informacioni, sherbime legale, ekspozita tregtare etj".

Kjo kerkese eshte e drejte edhe si e tille duhet te pranohet.

**PER KETO ARSYE**

Ne baze te ligjit Nr.7638, dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit Nr.7667, dt 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te".

**V E N D O S A:**


-Pranimin e kerkeses;

-Rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregtare me perjegjesi te kufizuar "Gips-Karton" sh.p.k., me ortak te vetem dhe administrator z. Shpetim Sukthi, me kapital 100.000 leke, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me adresë: Rruga "Pjeter Bogdani", Nr.5, Tirane, me objekt veprimtarie si me poshte: "Importe-eksport, me shumice e pakice te lendeve te para, materialeve te ndertimit, pajisjeve, makineri, etj; Punime dekorative me baze gips; Veprimitari ne fushen e sherbimeve, manifakture, perpunime industriale, transport, etj; Konsulence marketingu e sherbime te ngashme, misione tregtare, kerkim tregu, byro informacioni, sherbime legale, ekspozita tregtare etj".

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne shkalle te dyte.

**GJYQTARE**

*Anje me Coco  
Anje me Coco*





## AKTI I THEMELIMIT

### I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI

#### TE KUFIZUAR "GIPS-KARTON" SH.P.K.

**(Kontrata)**

Une Shpetim Sukthi, lindur me 04.09.1973, ne Tirane, banues ne rrugen "Pjeter Bogdani", Pallatet e Aviacionit, Tirane, me profesion tregetar, ne perputhje me kreun e katert te ligjit Nr.7638, dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ne kete akt vendosa qe te krijoj Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "Gips-Karton" sh.p.k.

#### **1. FORMIMI I SHOQERISE**

- 1.1 Formohet shoqeria tregtare private me Pergjegjesi te Kufizuar "Gips-Karton" sh.p.k.. Shoqeria do t'i nenshtrohet legjislacionit shqiptare, ndersa deget qe mund te krijohen jasht do t'i nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega.
- 1.2 Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelimi dhe statutit te shoqerise, qe do te miratohet nga ortaku themelues Shpetim Sukthi.

#### **2. ADRESA E SHOQERISE**

Shoqeria do te kete qendren e saj ne qytetin e Tiranes, ku do te kete aktivitetin e saj kryesor ekonomik. Seline e saj te pare do ta kete ne rrugen "Pjeter Bogdani", Numer 5, Tirane.

Shoqeria ka te drejte te hape edhe agjensi apo dege ne rrethe te tjera.

#### **3. OBJEKTI I SHOQERISE**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- 3.1 "Importe-eksporte, me shumice e pakice te lendeve te para, materialeve te ndertimit, pajisjeve, makineri, etj;
- 3.2 Punime dekorative me baze gips;
- 3.3 Veprimtari ne fushen e sherbimeve, manifakture, perpunime industriale, transport, etj;
- 3.4 Konsulence marketingu e sherbime te ngashme, misione tregtare, kerkim tregu, byro informacioni, sherbime legale, ekspozita tregtare etj"

#### **4. KOHEZGJATJA**

Shoqeria do te kete nje aktivitet prej me shume se 10 vjet.

#### **5. KAPITALI I SHOQERISE**

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqerise "Gips-Karton" sh.p.k, perbehet nga kontributi i ortakut te vetem Shpetim Sukthi, ne vlefsten 100.000 (njeqind mijë) leke. Kapitali themelor eshte i ndare ne 100 pjesë te barabarta. Vlera nominale e te cilave do te jete 1000 leke.
- 5.2 Kapitali themelor do te jete kontribut ne para dhe eshte i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Ortaku ka te drejte te zmadhoje kapitalin e tij ne natyre dhe ne para. Ne keto raste behen veprimet perkatese si per pjesmarjen e ortakeve ne kapitalin themeltar. Gjithashtu ortaku ka te drejte te

zvogeloje kapitalin e tij. Zvogelimi behet ne propocion te drejte per cdo ortak ne masen e kontributit themelor.

**5.3** Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut te vetem te shoqerise z.Shpetim Sukthi.

**5.4** Ortaku themelues ka te drejte te emeroje dhe administrator te tjere te vlerave materiale te shoqerise. Ai ka te drejte te caktoje financiere, likuidatore per problemet e shoqerise, si edhe te pajtoje persona te tjere si ortake. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiere tre-mujore, gjashte-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

**5.5** Kapitali themeltar eshte i depozituar ne njerun prej bankave te Shtetit, para fillimit te veprimitarise se Shoqerise.

**5.6** Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem ne rruge trashegimie.

## **6. FITIMI**

Fitimi i realizuar nga veprimitaria e shoqerise sic u percaktua mesiper, merret nga ortaku i vetem, mbasi edhe kontributi ne kapitalin themeltar eshte i tij.

## **7. KONTRIBUTET E KAPITALIT**

Sasia e kapitalit social te derdhur sipas pikes 1.5 te ketij akti themelimi do te quhet "Kontribut Kapitali", kontribut ky ne te cilin pala ka kuotat e percaktuara sipas dispozites.

Kontributi i Kapitalit fillimisht do te perdoret per shpenzimet fillestare te shoqerise.

## **8. FINANCIMI**

Per aq sa do te jete e mundur shoqeria ka te drejte te siguroje financimin tregtar ose investues nga cdo banke e institucion financier, te huaj ose shqiptar, financim qe do te rregullohet me ane te kontratave ose marrveshjeve te posacme me pelqimin e ortakut e administratorit te vetem Shpetim Sukthi.

## **9. CESHTJET FINANCIARE DHE LLOGARIA E SHOQERISE**

Shoqeria "Gips-Karton" sh.p.k, do te mbaje llogarite duke u mbeshtetur ne lekun shqiptar dhe ne valutat e forta. Per kete arsye ajo ne banken me te cilin do te operoje do te kete dy llogari rrjedhese, njerun ne monedhen shqiptare dhe tjetren ne valute te forte te huaj (si euro, dollare). Shoqeria do te kete si vit fiskal vitin kalendarik.

## **10. STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

### **10.1 ORGANET E SHOQERISE**

Organet e shoqerise jane:

- Asamblea, e cila perbehet prej ortakut e administratorit te vetem z.Shpetim Sukthi.
- Ekspertet kontabel.

**10.2** Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore do te hartohen nga Administratori z.Shpetim Sukthi.

Ortaku i vetem mund te delegoje kompetencat e tij tek persona te tjere. Vendimet e tij, te marra ne vend te asamblese, evidentohen ne nje rregjister.

Ortaku i vetem miraton llogarite, nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabel autorizuar prej tij, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit finanziar.

**10.3** Te gjitha komunikimet me ortakun e vetem, si dhe ndermjet perfaqesuesve te ortakut te shoqerise do te kene vlera ne rast se do te komunikohen me letra rekomande, emaile, telegrame, telekse, telefakse ose dorazi me shkrim. Vendimet e marra nga asamblea do te kene vlera pasi te noterizohen.

## 11. ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

Ortaku i vetem bie dakort qe te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin midis tij dhe Personave te tjere fizike dhe juridik apo te tretet, do t'i zgjidhe me mirkuptim, ose ne te kundert do t'i drejtohet Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

## 12. DISPOZITE E FUNDIT

**12.1** Ndryshimet ne kete akt mund te behen vetem me shtese me shkrim pas miratimit paraprak nga themeluesi.


Pjesa e pandare e ketij akti eshte statuti i shoqerise i cili do te ndershkruhet njekohesisht nga themeluesia e shoqerise.

**12.2** Ky akt themelimi u hartua ne Tirane sot me date 21.06.2004, ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe duke patur secili prej tyre te njejtën vlerë.

**ORTAKU I VETEM**

**SHPETIM SUKTHI**

Nr. 4659 Rep.




**V E R T E T I M**

Sot me date 21.06.2004 (dymijeekater) u paraqit personalisht perpara meje z. Shpetim Sukthi, i panjohur prej meje, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi personal qe paraqiti, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili me deklaroi se ka hartuar jashtë kesaj zyre kete Akt Themelimi te shoqerise "Gips-Karton" sh.p.k. dñe une e nenshkruej ate rregullisht.

**N O T E R I**

NOTERE  
DRITA PEPI  
TIRANE



1776

## STATUTI



### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “GIPS-KARTON” SH.P.K

#### **1. HYRJE**

**1.1** Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar “Gips-Karton” sh.p.k krijohet mbi bazen e insiativës se lire dhe te kapitalit personal te ortakut te vetem Shpetim Sukthi, lindur me 04.09.1973, ne Tirane, banues ne rrugen “Pjeter Bogdani”, Pallatet e Aviacionit, Nr.5, Tirane, me pasaporte numer 1385094.

**1.2** Shoqeria krijohet dhe e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me te gjitha normat e ketij statuti dhe te legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise, si dhe ne ligjin Nr.7632, dt 04.11.1992 “Per dispozitat qe rregullojnë pjesen e pare te Kodit Tregtar” dhe ligjit Nr.7638, dt 09.11.1992 “Per shoqerite Tregtare”.

**1.3** Shoqeria “Gips-Karton” sh.p.k i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

#### **2. OBJEKTI**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

**2.1** Importe-eksporte, me shumice e pakice te lendeve te para, materialeve te ndertimit, pajisjeve, makineri, etj;

**2.2** Punime dekorative me baze gips;

**2.3** Veprimtari ne fushen e sherbimeve, manifakture, perpunime industriale, transport, etj;

**2.4** Konsulencë marketingu e sherbime te ngjashme, misione tregtare, kerkim tregu, byro informacioni, sherbime legale, eksposzita tregtare etj

#### **3. EMRI, SELIA, TERRITORI**

**3.1** Shoqeri do te quhet “Gips-Karton” sh.p.k. Ajo si subjekt do te krijoje personalitetin e saj juridik ne daten e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane.

**3.2** Shoqeria do te kete qendren e saj te pare ne qytetin e Tirane, ne Rrugen “Pjeter Bogdani”, Numer 5.

**3.3** Ajo mund te krijoje dege apo agjensi dhe ne rrethe te tjera te Shqiperise.

#### **4. KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE**

**4.1** Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributi i ortakut te vetem ne vleften 100.000 (njeqind mijë) leke. Kapitali themelor eshte i ndare ne 100 pjese te barabarta. Vlera e te cilave do te jete me 1000 leke. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

**4.2** Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te luejteshme ose te paluejteshme etj., te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

**4.3** Kuotat e kapitalit fillestar sigurohen nga ortaku themelues dhe eshte i rregjistruar ne librin e llogarise te shoqerise.

**4.4** Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, i takojne ortaku themelues, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

**4.5** Shoqeria tregtare "Gips-Karton" shpk eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise, shoqeria tregtare "Gips-Karton" shpk, gezon te drejta, sikunder cdo person tjeter juridik, shqiptare ose i huaj, ne perputhje me legjisacionin ne fuqi.

**4.6** Shoqeria tregtare "Gips-Karton" shpk vepron ne rregjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaku themelues i shoqerise Shpetim Sukthi mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

## **5. KOMPETENCAT E ORTAKUT THEMELUES**

Hyjne brenda detyrave dhe komptencave te ortakut themelues si me poshte :

1. Ndryshimi i aktit te themelimit dhe i statutit te shoqerise;
2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve te administrimit, i inventareve dhe i bilancit e llogarise vjetore;
3. Zgjedhja e administratoreve jo - ortake dhe caktimi i detyrave dhe i kompetencave te tyre, me perjashtim te atyre qe shenohen ne statut;
4. Vendos per marrien e kredive si dhe per mbarimin e Shoqerise;
5. Miratimi i tarifave per sherbimet qe kryen shoqeria;
6. Shqyrton bilancin vjetor, kuotat, fondet e ndryshme si dhe fitimin e realizuar;
7. Pranimet dhe largimet ne pune;
8. Caktimi i formes se vules dalluese te shoqerise;
9. Kryerja e te gjitha veprimeve te administrimit te shoqerise ne emer, per llogari dhe per interes te saj.
10. Ortaku i vetem mund te delegoje kompetencat e tij tek persona te tjere. Vendimet e tija, te marra ne vend te asamblese, evidentohen ne nje rregjister;
11. Vendos per politiken afariste te Shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se Shoqerise;
12. Vendos per krijimin e degeve e agjensive te Shoqerise brenda dhe jashte vendit;
13. Emeron nje ose disa eksperte kontabel per te ushtruar kontroll mbi aktivitetin ekonomiko-financiar te Shoqerise;
14. Miraton ose realizon mardheniet e shoqerise me persona te tjere fizike dhe juridike;
15. Vendos per pagat e punonjesve te punesuar ne kete Shoqeri.

## **6. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

1. Shoqeria do te drejtohet nga Administratori dhe ortaku i vetem Shpetim Sukthi.
2. Te mire-administroje pasurine e shoqerise;
3. Te beje marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise;
4. Te zbatoje rregulloren e brendshme te shoqerise;
5. Te pergiqjet per demet qe i sjell shoqerise nga veprimet e tij;
6. Te marre te dhena dhe te beje propozime per gjithcka qe e cmon si te dobishme per shoqerine;
7. Te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise;
8. Te beje raportin e administrimit, inventarin dhe llogarite vjetore.

## **7. ASAMBLEJA E ORTAKUT TE VETEM**

Asamblea eshte organi me i larte i shoqerise. Asambleja eshte organi qe merr vendime ne emer te shoqerise. Ai si organ organizon dhe kontrollon gjithe aktivitetin e shoqerise.

Ortaku i vitem perballon humbjen e shoqerise deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij.

Ne ushtrimin e te drejtes per te marre pjese ne vendimet kolektive, ortaku ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjeter i zgjedhur prej tij me akt notarial.

## **8. MBLEDHJET E ASAMBLESE**

Asamblea eshte e zakonshme ose e jashtezakonshme.

Asamblea e zakonshme duhet te mblidhet te pakten 2 here ne vit, por si asamblea e zakonshme dhe e jashtezakonshme mund te mblidhet sa here qe organi administrativ apo ortaku e gjen me yend.

## **9. FORMALITETET E MBLEDHJES**

**9.1** Asamblea mund te mblidhet me leter rekomande shpallur ne mjediset e shoqerise, te pakten 7 dite para mbledhjes.

**9.2** Letra e thirjes do te permbaje pershkrimin e vendit, te dites e te ores se mbledhjes dhe rendin e dites te ceshqeve qe do te trajtohen.

**9.3** Vendimet e asamblese duhen hedhur ne procesverbal, i cili nenshkruehet nga drejtuesi i saj dhe nga noteri.

**9.4** Asamblea e zakonshme, si ne thirjen e pare edhe ne te dyten vendos me shumice votash. Thirja e dyte behet kur ne te paren nuk eshte prezent ortaku i vetem. Ajo mblidhet brenda 30 diteve nga thirja e pare.

**9.5** Vendimet miratohen sipas *menyrave te votimit* qe percaktohen rast pas rasti nga mbledhja e ortakut te vetem.

## **10. MARREDHENIET EKONOMIKE - FINANCIARE TE SHOQERISE**

**10.1** E gjithe veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomike te saj.

**10.2** Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni finanziar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 Mars te cdo viti nxirret bilanci.

**10.3** Shoqeria mban xhiro-llogarite ne Banke. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkates.


**10.4** Nga fitimet e realizuara gjate vitit financier, shoqeria, pasi ben zbritjen e humbjeve te vitit te meparshem, le menjane 5 % te fitimit, me te cilin krijohet fondi "Rezerve e domosdoshme", derisa ky fond te arrrije ne masen 10 % te kapitalit themeltar.

**10.5** Te ardhurat neto, pas vecimit te fondeve te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, i mbesin ne perdonim ortakut themelues te shoqerise.

Konvertimi i parase te realizuar nga shitja do te behet sipas kushteve qe do te kete Banka e Shqiperise, ose Banka te tjera private dhe transferimi i saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

## **11. KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Kjo shoqeri krijohet per nje afat mbi 10 vjet.



## 12. SHNDRRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

**12.1** Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendimin e ortakut te vetem ne keto raste: kur veprimtaria e saj nuk rezulton fitimprurese, per shkak te forcave madhore, si dhe per shkaqe te tjera ligjore.

**12.2** Shperberja e shoqerise, mund te vije ne cdo kohe per cfardo shkaku, si:

- Humbja e kapitalit te shoqerise;
- Pamundesi veprimi;
- Me vendim te asamblese se ortakeve (Ortaku i vetem themelues).

Ne keto raste, pronari i shoqerise vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat.

Likuidatori eshte perjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise per derisa ajo t'u dorezohet personave perkates fizik ose juridik, duke likuiduar ne rradhje te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria.

Ne rast se fondej disponibel, rezultojne te pamjaftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund t'i kerkoje ortakut themelues te shoqerise qe te derdhe teresisht kuotat qe i takojne atij.

## 13. MARDHENIET E PUNESIMIT

**13.1** Cdo person i punesuar ne shoqeri fillon aktivitetin e tij mbi bazen e kontrates se punes te lidhur ndermjet tij dhe Shoqerise, ne perputhje me legjisacionin e punes ne Shqiperi;

**13.2** Cdo person i punesuar ne shoqeri eshte personalisht perjegjes per kryerjen e detyres.

## 14. DISPOZITAT E FUNDIT

**14.1** Viti finanziar i shoqerise fillon me 1 Janar te cdo viti dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

**14.2** Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve Shoqerore te Republikes se Shqiperise.

**14.3** Shoqeria do te kete vulen e saj ne formen dhe simbolin e percaktuar nga ortaku.

Ky statut u themelua sot me date 21.06.2004 ne Tirane nga ortaku i vetem.



**ORTAKU I VETEM**

**SHPETIM SUKTHI**

Nr. 400... Rep.

**VERTETIM**

Sot me date 21.06.2004 (dymjeekater) u paraqit personalisht perpara meje z. Shpetimi Sukthi, i panjohur prej meje, per identitetin e te cilil u sigurova nga leternjofimi personal qe paqafiqi madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, i cili me deklaroj se ka hartuar jashtë kesaj zyre kete Statut te shoqerise "Gips-Karton" sh.p.k dhe une e nenshkruej ate rregullisht.

**NOTERI**

NOTERE  
DRITA PEPI  
TIRANE



318/18

1

22 QERSOR 2004 A Coco  
Tirane me 21.06.2004

## KERKESE

**KERKUESI:** Shpetim Sukthi, lindur me 04.09.1973, ne Tirane, banues ne rrugen "Pjeter Bogdani", Pallatet e Aviacionit, Tirane.

**OBJEKTI:** Rregjistrimi si person juridik i shoqerise tregtare "Gips-Karton" shpk.

Baza Ligjore: Ligji Nr.7638, dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligji Nr.7667, dt. 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar".

## PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

Une, kerkuesi i sipershnuar jam administratori dhe ortaku i vjetem i Shoqerise "Gips-Karton" shpk, prandaj kerkoi rregjistrimin si person juridik te kesaj shoqerie tregtare me kushtet e eposhtme:

"Emertimi i shoqerise eshte "Gips-Karton" shpk; Objekti i shoqerise eshte: "Importesporte, me shumice e pakice te lendeve te para, materialeve te ndertimit, pajisjeve, makineri, etj; anime dekorative me baze gips; Veprintari ne fushen e sherbimeve, manifakte, perpunime dustriale, transport, etj; Konsulencje marketingu e sherbimeve ngashme, misione tregtare, kerkim i gu, byro informacioni, sherbime legale, ekspozita tregtare etj". Selia e shoqerise eshte ne Tirane, e adrese: rruga "Pjeter Bogdani", Numer 5, Tirane.

Kapitali fillestari i depozituar ne banke eshte 100.000 leke qe ndahet si vijon: Kapitali eshte 100 pjesa te barabarta, vlera nominale e te cilave do te jetonte 1000 leke.

Shoqeria private do te zhvilloj aktivitetin e saj per nje periudhe 10 vjetore. Veprintaria e saj te zhvillohet ne Tirane dhe do te shtrihet ne te gjithe territorin e Republikas se Shqiperise".

Bashkengjitur me kete kerkese paraqiten dokumentai perkatose: Akti i Themelimit i Shoqerise si dhe dokumenti bankar per depozitim i kapitalit themeltar.

Mbetem me shprese se kerkesa ime do te merret ne considerate.

ADMINISTRATG

SHPETIM SUKT

PO

Nr. 1791 Rep.




VERTE TIM

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
NOTERIA

Sot me date .06.2004 (dymijeekater) u paraqit perparat e parat perparat meje z. Shpetim Sukthi, injohur prej meje, per identitetin e te cilil u sigurova nga leterojoftimi personal qe paraqiti, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili me deklaron se ka hartuar jashtje zyre kete kerkese dhe pasi e firmosi une noteri e vertetova si pos ligji.

NOTE RI

NOTE RE  
DRITA PEPI  
TIRANE





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE



Nr. 89 Rep.

**VERTETIM NOTERIAL**

Sot me dt. .06.2004 (dymjekater) u paraqiten personalisht para meje, noterit, ortaku i vetem i shoqerise "Gips-Karton" sh.p.k. z. Shpetim Sukthi, lindur me 04.09.1973, ne Tirane, banues ne rrugen "Pjeter Bogdani", Pallatet e Aviacionit, Tirane, Nr.5, me pasaporte 1385094, madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, i cili depoziton si kapital themelor prane zyres te noterit vleften prej 100.000 (njeqind mijë) leke.

Une noteri ne baze te nenit 40, te ligjit Nr.7638, dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe statutit te shoqerise "Gips-Karton" sh.p.k., mora si depozite per kapitalin themelor te kesaj shoqerie te themeluar nga ortaku dhe administratori i vetem Shpetim Sukthi, vleften prej 100.000 (njeqind mijë) leke.

Kete vertetim e leshoj ne baze te kompetences qe me jep ligja e mesiperme, si pjesa qe do t'i bashkelidhet statutit te shoqerise "Gips-Karton" sh.p.k.

**NOTERI**

NOTESE  
DRITA PEPI  
TIRANE



